



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**  
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE**

---

**VENDIM**  
**Nr. 10, Dt. 25.09.2008**

*Per miratim te kerkeses per marrje leje, per perdorim uji, prej burimeve ujore te lumit te Smokthines, perroit te Leshnices, burimeve te Bunecit, lumit te Podes, lumit te Barmashit dhe burimeve te Borshit per prodhim te energjise elektrike nepermjet HEC-ve, prej subjektit "Ballkan Green Energy" sh.p.k, Tirane.*

Ne plotesim te kerkeses te bere prej subjektit "Ballkan Green Energy" sh.p.k dhe ne zbatim te kerkesave qe percakton Ligji Nr.8093 Dt. 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", te ligjit nr. 9663, dt. 18.12.2006 per "Koncesionet", vendimit te K.M nr.27, dt. 19.01.2007 "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve" vendimit nr.3, dt.19.07.2002 te K.K.U-se, "Per miratimin e rregullores te sekretariatit Teknik" te K.K.U-it, te K.B.U –se dhe A.U-it, udhezimit te M.M.P.A.U dhe M.E.T.E, Vendimit nr.467, dt. 03.10.2002 te K.M "Per miratimin e kontrates koncesionare te formes ROT", ndermjet Ministries te Indistrise Energjitikes dhe Ekonomise dhe nga ana tjeter shoqerise italiane Esegei, per HEC-et vendore, vendimit nr.148, dt. 22.03.2007, "Per disa shtesa dhe ndryshime ne marreveshjen e koncesionit te formes ROT", lidhur ndermjet Ministries te Energjitikes Ekonomise dhe Industrise dhe shoqerise italiane Esegei nga ana tjeter, dhe vendimit nr.69, dt. 12.12.2007, per shqyrtimin e transferimit te licences nga shoqeria H.C.A sh.p.k, tek shoqeria Ballkan Green Energy sh.p.k

Keshilli i Basenit Ujembledhes "Vjose",

**VENDOSI:**

I- Miratimin e kerkeses per dhenie *Leje, "Per perdorim te ujit"* per prodhim te energjise elektrike, nepermjet HEC-ve:

- 1- Smokthines - Me ujerat e lumit Smokthine.
- 2- Leshnice - me ujerat e perroit te Leshnices.
- 3- Piqeras - me burimet dhe perroit e Bunecit.
- 4- Rajan - me ujerat e lumit te Podes.
- 5- Barmash - me ujerat e lumit Barmash.
- 6- Borsh - me ujerat e burimeve te Borshit.

II- Veprat e marrjes, do te jene ne vendet me koordinata:

Per HEC-in Smokthine:

X = 44 64 275

Y = 43 95 725

Z = 412 m

**\* Vazhdim i Vendimit Nr. 10 , Dt. 25.09.2008**

Per HEC-in Leshnice:

X = 44 13 037      Y = 44 38 150      Z = 600 m

Per HEC-in Barmash:

X = 44 59 875      Y = 44 66 075      Z = 780 m

Per HEC-in Rajan:

X = 44 58 725      Y = 44 65 250      Z = 710 m

Per HEC-in Piqeras:

X = 44 31 150      Y = 44 06 525      Z = 39 m

Per HEC-in e Borshit:

X = 44 36 875      Y = 44 02 550      Z = 122 m.

III - Sasia e ujit qe jepet ne perdorim, per prodhim te energjise, per cdo HEC-al do te jete:

- 1- Per HEC-in Smokthine 6 m<sup>3</sup>/sek
- 2- Per HEC-in Leshnice 0.4 m<sup>3</sup>/sek
- 3- Per HEC-in Barmash 1.1 m<sup>3</sup>/sek
- 4- Per HEC-in Rajan 3.2 m<sup>3</sup>/sek
- 5- Per HEC-in Piqeras 1 m<sup>3</sup>/sek
- 6- Per HEC-in e Borshit 0.59 m<sup>3</sup>/sek

IV - Periudha e perdorimit te ujit do te jete gjate gjithe vitit, perjashto periudhen nga 1 Maj deri ne 31 Gusht te cdo viti, ku prurjeve te mesiperme te ujit do tu zbriten sasia e ujit qe do te perdoret per kulturat bujqesore:

- 1- Per HEC-in Smokthine 0.2 m<sup>3</sup>/sek
- 2- Per HEC-in Leshnice 0.1 m<sup>3</sup>/sek
- 3- Per HEC-in Barmash 0.1 m<sup>3</sup>/sek
- 4- Per HEC-in Rajan 0.2 m<sup>3</sup>/sek
- 5- Per HEC-in Piqeras 0.1 m<sup>3</sup>/sek
- 6- Per HEC-in e Borshit 0.2 m<sup>3</sup>/sek

V -Ngarkohet A.U.B “Vjose” per zbatimin e ketij vendimi.

VI- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

**PERGJEGJES I A.U.B-se “VJOSE”**



**KRYETARI I K.B.U “VJOSE”**  
**Hasan HALILI**

